



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

**Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike / Odbor Kosovske Akademije za Javnu
Bezbednost / Board of Kosovo Academy for Public Safety**

Nr. 1/11

Datë: 08.06.2015

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike si dhe në bazë të nenit 4 dhe nenit 11 të Rregullores Nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në mbledhjen e mbajtur më 08 qershor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 10-të e Bordit të AKSP-së të mbajtur me datë 09.03.2015.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Bordit, dhe
- Arkivit të AKSP-së

Shpend Maxhuni

Kryesues i Bordit



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike / Odbor Kosovske Akademije za Javnu
Bezbednost / Board of Kosovo Academy for Public Safety

Nr. 2-11
Datë: 08.06.2015

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, nenit 4 dhe 11 të Rregullores Nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike si dhe nenit 36 të Rregullores Nr. 26/2013 për Arsimin e Lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në mbledhjen e mbajtur më 08 qershor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Caktohen kuotat e institucioneve të sigurisë publike për vendet e studimit në studimet themelore bachelor në sigurinë publike në Akademi për vitin akademik 2015-2016.
2. Kuotat për pranim në Akademi në studimet themelore bachelor në sigurinë publike për vitin akademik 2015-2016 për zyrtarët e Institucioneve të Sigurisë Publike janë të ndara si në vijim:
 - 2.1. Policia e Kosovës 20 studentë;
 - 2.2. Dogana e Kosovës 5 studentë;
 - 2.3. Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave 11 studentë;
 - 2.4. Shërbimi Korrektues i Kosovës 19 studentë;
 - 2.5. Shërbimi Sprovues i Kosovës 5 studentë, dhe
 - 2.6. Inspektorati Policor i Kosovës 5 studentë.
3. Nëse institucioni përkatës nuk i shfrytëzon vendet sipas kuotës së përcaktuar, kuota plotësohet me studentët nga institucioni tjetër.
4. Obligohet Akademia e Kosovës për Siguri Publike dhe Institucionet e Sigurisë Publike nga pika 2 për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Shpend Maxhuni

Kryesues i Bordit

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Bordit
- AKSP, PK, DK, AME, SHKK, SHSK, IPK, dhe
- Arkivit të AKSP-së